

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR NËNPRODUKTET ME ORIGJINË SHTAZORE¹”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Me këtë projektligj përafrohet pjesërisht rregulloja e (KE) nr. 1069/2009 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009 “Që përmban normat sanitare që i përkasin nënprodukteve me origjinë shtazore dhe derivateve të tyre të cilat nuk janë të destinuara për konsum nga njerëzit dhe që shfuqizon rregulloren (KE) nr. 1774/2002.

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i normave të kontrollit shëndetësor që i përkasin nënprodukteve me orgjinë shtazore dhe derivateve të tyre, si dhe në veçanti, mbrojtjes së sigurisë në zinxhirin e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë.

Projektligji synon gjithashtu përcaktimin në mënyrë shteruese të përkufizimeve të nënprodukteve me origjinë shtazore që nuk synohen të konsumohen nga njeriu, sipas përkufizimeve në legjislacionin e Bashkimit Evropian, duke diferencuar qartë përkufizim e mbetjeve, çka garanton zbatimin e ligjit në harmoni me ligjet e tjera. Projektakti përcakton kufizimet e përdorimit duke parashikuar ndalimin e përdorimit të nënprodukteve dhe produkteve derivate të tyre për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara nga ky akt dhe ngarkon autoritetet kompetente për të garantuar zbatimin e këtyre ndalimeve.

Projektligji ka si objektiv përcaktimin e rregullave në mënyrë shteruese, në të gjitha fazat e procesit që nga mbledhja, transporti, menaxhimi, trajtimi, transformimi, përpunimi, magazinimi, futja në treg, shpërndarja, përdorimi dhe asgjësimi.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është parashikuar në Programin Analitik të Akteve që do të miratohen për vitin 2024 por synohet miratimi brenda vitit 2024.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Legjislacioni në fuqi në Shqipëri nuk ka mjedis rregullator për nënproduktet me origjinë shtazore që nuk konsumohen nga njeriu. Ligjin nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” parashikon në nenin 36 nxjerrjen e vendimit të Këshillit të Ministrave por nga hyrja në fuqi e këtij ligji në vitin 2011, ky aktet nënligjor nuk është miratuar. Në ndërkohë që Bashkimi Evropian në legjislacionin e tij ka në fuqi rregulloren (KE) nr.1069/2009 të Parlamentit evropian dhe Këshillit, dt. 21 tetor 2009 “Që përmban normat sanitare që i përkasin nënprodukteve me origjinë shtazore dhe derivateve të tyre të cilat nuk janë të destinuara për konsum nga njerëzit dhe që shfuqizon rregulloren (KE) nr. 1774/2002”, pra, një akt të mëvetësuar.

Problematikat e hasura janë :

- Nuk ka legjislacion lidhur me nënproduktet me origjinë shtazore që nuk konsumohen nga njeriu, në nivel ligji ose të vendimit të Këshillit të Ministrave.
- Ligji nr.10465/2011, Për shërbimin veterinar në “Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka disa referime minimale, të cilat nuk rregullojnë fushën e nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate që rrjedhin nga përpunimi i tyre.
- Ligjin nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, përcakton detyrimin e aktit nënligjor - vendim i Këshillit të Ministrave, nenin 36, por nuk ka masa administrative ndaj shkeljeve dhe nuk ka përcaktuar detyrimin e operatorëve të biznesit që të licensohen, që të mbledhin, përpunojnë dhe tregtojnë, importojnë dhe eksportojnë nënproduktet me origjinë shtazore që nuk konsumohen nga njeriu, mungesa që sjellin si pasojë mos

garantimin e zbatimit cilësor të ligjit. Ky ligj përfaqëson Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Mbi mbetjeve”. Direktiva në fjalë i përjashton nënproduktet me origjinë shtazore nga fusha e ndikimit të saj. Ligji nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ka krijuar paqartësi në këtë çështje, pasi përjashton një pjesë të nënproduktet me origjinë shtazore dhe përfshin një pjesë tjetër.

- Ligji nr.10463, datë 22.9.2011 dhe Ligji nr.10465/2011, ka përcaktuar përkufizimin për nënproduktet me origjinë shtazore që nuk konsumohen nga njeriu, por ka përcaktuar dhe një përkufizim të “mbeturinave me origjinë shtazore” duke krijuar paqartësi ndërmjet nënprodukteve me origjinë shtazore dhe mbetjeve.

Ndërkohë projektligji përcakton në mënyrë shteruese ndarjen ndërmjet nënprodukteve me origjinë shtazore që nuk synohet të konsumohen nga njeriu dhe mbetjeve me origjinë shtazore, gjithashtu miraton bazën e munguar rregullore, në harmoni dhe me legjislacionin në fuqi për “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Projektligji synon përfaqësimin e pjesshëm të rregullores nr.1069/2009, për aq sa është e mundur që të zbatohet në vendin tonë duke mos qënë akoma vënd anëtar. Projektligji parashikon rregulla përsa i përket zbatimit të tij që kanë të bëjnë me institucionet zbatuese, procesin e licensimit, masat ndaj kundërvajtjeve administrative, ankimin, çështje këto që normohen nga legjislacioni kombëtar.

Efektet e pritshme :

- Projektligji përmbush detyrimin për miratimin e legjislacionit kombëtar në përputhje me legjislacionin e BE-së, kërkesë kjo në takimet bilaterale me BE-në.
- Projektligji krijon bazën e munguar rregullore, në nivel ligji, lidhur me nënproduktet shtazore që nuk synohet të konsumohen nga njeriu, me normim shterues në tërësinë e fazave në të cilat kalojnë nënproduktet me origjinë shtazore që nuk konsumohen nga njeriu.
- Projektligji ndikon në mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe njerëzve pasi nënproduktet kanë potencialisht ndikim negativ në përhapjen e sëmundjeve tek kafshët dhe njerëzit nëse nuk mbledhen, përpunohen dhe shpërndahen në përputhje me rregullat e këtij ligji.

- Projektligji ndikon në mbrojtjen e mjedisit pasi nënproduktet janë potencialisht me ndikim negativ në ndotjen e tij nëse nuk mblidhen, përpunohen dhe shpërndahen në përputhje me rregullat e këtij ligji..
- Nxit aktivitetin e operatorëve ekonomikë që mbledhin dhe përpunojnë nënprodukte, dhe i tregtojnë ato, pas përpunimit sipas këtij ligji. Aktiviteti i operatorëve ekonomikë kryhet bazuar në licencat që lëshohen pas verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore.
- Vendosen masa shtërnguese ndaj shkelësve të ligjit, me dënime administrative, ndërkohë që shkeljet që përbëjnë vepër penale dënohen sipas Kodit Penal në Republikën e Shqipërisë.
- Përcaktohet parimi “*ndotësi paguan*”, pra, dëmet që kanë vlerë financiare, ndaj çdo subjekti, shtetëror ose privat, paguhet nga individi ose subjekti që e shkakton.

Ky projektakt është në harmoni me disa akte të tjera që po hartohen nga MBZHR, që ndërlidhen në zbatim me këtë akt dhe konkretisht, me projektligjin për kontrollet zyrtare dhe projektligjin për shëndetin e kafshëve.

Projektligji shfuqizon dispozitat ligjore në Ligjin për shërbimin veterinar dhe Ligjin për Mbetjet, duke krijuar një ligj të mëvetësuar për nënproduktet me origjinë shtazore që nuk synohen të konsumohen nga njeriu.

Projektligji synohet të miratohet në vitin 2024 por parashikohet të shtrijë efektet nga data 1 shkurt 2026, në raport me hyrjen në fuqi të ligjeve të tjera në proces përafrimi që ndërlidhen me të, të cilat po ashtu synohet të miratohen gjatë vitit 2024.

Hyrja në fuqi dhe shtrirja e efekteve në një periudhë të mëvoshme krijon kushtet e përshtatjes së subjekteve tregtare me rregullimet ligjore dhe mundëson zbatimin të institucioneve shtetërore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është në përputhje me nenet 78 dhe 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektakt ka përafrim të pjesshëm të Rregullores (KE) nr.1069/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datët 21 tetor 2009 “Që përmban normat sanitare që i përkasin nënprodukteve me origjinë shtazore dhe derivateve të tyre të cilat nuk janë të destinuar për konsum nga njerëzit dhe që shfuqizon rregulloren (KE) nr.1774/2002 (Rregullore mbi nënproduktet me origjinë shtazore)”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është i strukturuar në 13 Krerë, në total i përbërë nga 52 nene.

Kreu 1 ka dispozitat e përgjithshme që lidhen me neni 1 – qëllimi, neni 2- fusha e zbatimit, dhe neni 3- përkufizime.

Dispozitat e përgjithshme përcaktojnë qartë se ligji krijon mjedis rregullator të dedikuar për nënproduktet me origjinë shtazore që nuk synohen të konsumohen nga njeriu (*Animal by product*). Në këtë kuptim dhe përkufizimet janë të qarta por vetëm për këtë fushë, sipas përkufizimeve të Rregullores (KE) nr.1069/2009.

Kreu 2, zinxhiri i prodhimit, detyrimet dhe kufizimet, përbëhet nga 3 nene, që përcaktojnë tërësinë e proceseve që rregullohen dhe në të cilat operatorët kanë detyrime dhe kryejnë veprimtarinë e tyre. Neni 4 rregullon pikën (çastin) e fillimit të aplikimit të ligjit dhe rrjedhimisht të detyrimeve, ku veterinari zyrtar përcakton kategorinë, regjistrojnë dhe përcaktojnë masat që ndërmeren, bazuar në këtë ligj. Më tej, neni 5, përcakton pikën fundore, pas përpunimit dhe dalin nga fushëveprimi i këtij ligji. Në kushtet që përcaktohet hyrja në regjimin e këtij ligji por dhe pika fundore, në këtë kre, në nenin 6 përcaktohen dhe kufizimet që rrjedhimin nga shëndeti i kafshëve.

Kreu 3 ka emërtesën kategorizimi. Nënproduktet ndahen në 3 kategori bazuar në rrishtun për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve. Nenet 8, 9, dhe 10, pjesë e kreut 3,

përcaktojnë rregullime specifike për secilën nga këto kategori. Në tre nenet e cituara, që për afrohen sipas rregullores, nuk lihet jashtë asnjë nënprodukt, por listohen në mënyrë shteruese secili prej tyre.

Kreu 4, ka emërtesën, Eliminimi dhe përdorimi i nënprodukteve me origjinë shtazore dhe i produkteve derivate dhe përbëhet nga 5 nene.

Neni 11 përcakton kufizimet e përdorimit dhe konkretisht ndalimin e përdorimit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate për ushqim për kafshët e listuara në pikën 1, shkronjat *a*, *b* dhe *c*. Nga ana tjetër në pikën 2, përcaktohen detyrimet e autoritetit kompetent përgjegjës për kontrollet zyrtare i cili në përmbushje të funksioneve ligjore kryen verifikimet dhe kontrollet për të garantuar zbatimin e ligjit dhe përmbushjen e qëllimeve të tij. Neni 12 fillon rregullimet për secilën kategori, duke filluar nga materialet e kategorisë 1, të cilat eliminohen ose përdoren si lëndë djegëse pa ose me transformim por, që gjithsesi është një formë eliminimi. Në vijim neni 13 përcakton eliminimin dhe përdorimin e materialeve të kategorisë 2, të cilat po ashtu mund të eliminohen si mbetje me djegie, ripërdoren pas djegies për prodhim energjie ose në landfill të autorizuar pas transformimit nëpërmjet sterilizimit nën presion. Por neni 13 përcakton në shkronjën *ç* që materialet mund të përdoren për fertilizantëve organik ose plehrave organike për ti futur në treg në përputhje me kërkesat e nenit 31. Një nga produktet që dalin në treg është prodhimi i fertilizantëve që pas prodhimit dalin nga fushëveprimi i këtij ligji. Në vijim në këtë nen përcaktohen dhe raste të tjerë të futjes në tregtim për transformimin në biogas, aplikohen në tokë pa transformim paraprak, silazhohen, përdoren si lëndë djegëse apo në raste të tjera. Neni 14, pas rregullimeve të materialeve të 2 kategorive të para, normon për herë të parë në ligj, materialet e kategorisë 3. Materialet e kësaj kategorie mund të eliminohen përmes djegies ose të ripërdoren. Kjo kategori materialesh përdoret për prodhim energjie, ushqim për kafshë kryesisht atyre të shoqërimit, për ushqimin e kafshëve që përdoren për prodhim e lëkurëve (prodhimin e gëzofëve) por jo për ushqimin e kafshëve që përdoren për ushqim për njerëzit, përdoren si lëndë djegëse apo në rastet e përcaktuara/listura në këtë nen. Theksojmë se qëllimi i përdorimit është listuar në mënyrë shteruese dhe nuk lejohet.

Kreu 5, me titull përjashtimet, përmban 5 nene. Konkretisht përcaktohen përjashtimet e regjimit për materialet e secilës kategori kur ato përdoren për kërkim shkencor dhe qëllime të tjera të veçanta të listuara në nenin 17. Neni 18 lejon përdorimin e veçantë për ushqimin e kafshëve. Ndërkohë neni 19 lejon po ashtu, me lejen e autoriteti kompetent që materialet e secilës kategori të eliminohen me grososje, djegie dhe grososjes në vend apo formave të tjera të eliminimit me prezencën e veterinerit të kontrollit. Autoriteti kompetent ndërkohë mban evidenca të sakta dhe të përditësuara mbi këto eliminime pavarësisht formës me të cilën eliminohen. Autoriteti kompetent autorizon metodat alternative për përdorimin ose eliminimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose produkteve derivate bazuar në normativat e BE-së.

Kreu 6, me titull, mbledhja, transporti, gjurmueshmëria dhe licensimi në 4 nene normon procesin duke filluar nga mbledhja dhe përcaktimi i kategorisë – vendimarrje e rëndësishme për proceset vijuese, transportin sipas kushteve të përcaktuara në ligj. Po ashtu në nenin 21, përcaktohen dokumentat që shoqëronë materialet gjatë transportit apo për tregtimin nga një subjekt tek tjetri.

Gjurmueshmëria është element i rëndësishëm i procesit dhe rregullohet në nenin 22, dhe detyron operatorët të mbajnë regjistër të veçantë të materialeve dhe dokumentacionit. Pra, detyrimi është i operatorëve dhe autoriteti kompetent në çdo rast mund të ndjek ecurinë e një materiali të caktuar, duke kontrolluar dokumentat dhe sistemet që ngrihen nga vet operatorët.

Aktiviteti i operatorëve të stabilimenteve dhe impianteve i nënshtrohet procsit të licensimit, parashikuar në nenin 23 të ligjit. Licensimi është gjithëpërfshirës, dhe konkretisht për grumbullojnë, transportojnë, përpunojnë, tregtojnë, magazinonjë, eliminojnë nënprodukte me origjinë shtazore dhe/ose produkte derivate. Neni 24 diferencon disa aktivitete që kryhen me leje nga autoriteti kompetent atëherë kur stabilimentet ose impiante zhvillojnë një ose me shumë nga aktivitetet e parashikuara në këtë nen.

Kreu 7, higjena përbëhet nga 2 nene, përkatësisht neni 25 dhe neni 26. Përpunimi i materialeve i nënshtrohet kushteve të rrepta të higjenës në stabilimentet ose impiantet, që marrin leje nga autoriteti kompetent. Po në këtë kre, në nenin 26 normohen proceset e përpunimit të nënprodukteve me origjinë shtazore nga operatorët e sektorit ushqimor. Pika 3 e nenit 26 referon zbatimin e praktikave

detyruese nga legjislacioni në fushën e veterinarisë, legjislacion detyrues për operatorët.

Kreu 8, kontrollet e brendshme, analiza e rriskut, dhe pikat kritike të kontrollit. Neni 27 lejon përdorimin e sistemit të vetëkontrollit (sistemi HACCP - Hazard Analysis and Critical Control Point). Është detyrë e operatorëve të sigurojnë sistem vetëkontrolli në zbatim të parimit të analizës së rriskut dhe të pikave kritike të vetëkontrollit. Manualët dhe praktikat e mira hartohen dhe shpërndahen nga Autoriteti kompetent.

Kreu 9, tregtimi. Neni 9 lejon futjen në treg të nënprodukteve për ushqimin e kafshëve që prodhojnë ushqime të ndryshme nga kafshët për prodhimin e lëkurëve duke plotësuar kushtet e parashikuara në këtë pikë që lidhen me faktin se duhet të derivojnë nga materiale të kategorisë 3. Për fertilizantët që prodhojnë ushqime të ndryshme nga kafshët për prodhimin e lëkurëve mund të futen në treg vetëm nëse derivojnë nga materiale të kategorisë 2 dhe 3 dhe plotësimi të kushteve të tjera specifike. Neni 32 lejon përdorimin e produkteve derivate si produkte kozmetike, aparatura mjekësore dhe barna ose barna veterinare. Neni 34 po ashtu riafirmon futjen në treg të ushqimeve për kafshët e shoqërimit por që derivojnë nga materialet e kategorisë 3. Në vijim neni 35 rregullon futjen në treg të produkteve të tjera derivate. Në cdo rast prejardhja e materialeve duhet të jetë e sigurt dhe nuk duhet që materialet të paraqesin rrisht për shëndetin publik. Operatorët mbajnë dokumentacion të plotë për përjashtimin e rriskut për shëndetin publik dhe të kafshëve që rrjedhin nga materiali fillestar.

Kreu 10, Importi, transiti dhe eksporti. Ligji vendos rregulla për nënproduktet me origjinë shtazore që importohen ose transitojnë nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të plotësojnë kushtet e nenit 39. Sikurse dhe legjislacioni i BE-së, në Republikën e Shqipërisë ndalohet importi dhe tranzitimi i materialeve të kategorisë 1 dhe 2, kjo sepse këto kategori janë më të rrezikshme për shëndetin publik. Pika 3 e nenit 39 lejon vetëm importet e materialeve të kategorisë 3, pra ato më pak të rrezikshmet, por vetëm për qëllimet e përpunimit dhe prodhimit të produkteve derivate. Ligji ndalon qartësisht importin e materialeve të kategorisë 3 për qëllime të gruposjes ose djegies.

Duhet theksuar se sikurse nuk lejohet importi, bazuar në legjislacionin e BE-së që përafrohet, ndalohet dhe eksporti i nënprodukteve me origjinë shtazore dhe i produkteve derivate të destinuara për djegie ose groposje.

Kreu 11, rregullon procedurat e kontrollit zyrtar dhe kërkesat përfundimtare. Pjesë e kontrollit zyrtar është dhe kontrolli para licensimit që garanton licensim të operatorëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret. Operatori ka detyrimin të ndalojë aktivitetin nëse licensa shfuqizohet ose anulohet. Kushtet e pezullimit dhe heqjes së licensës parashikohen nën nenin 42.

Kreu 12, përcakton masat ndaluese dhe kundërvajtjet administrative.

Neni 44 përcakton ndalimin e hedhjes ose eliminimit në vende të paautorizuara, në det, basene ujore, apo ndalime të tjera të parashikuara po në këtë nen. Për shkak të ndalimit, operatorët duhet të lidhin kontrata bashkëpunimi me operatorë të licensuar që kanë si objekt aktiviteti përpunimin ose/dhe eliminimin e nënprodukteve me origjinë shtazore. Neni 46 përcakton kundërvajtjet administrative dhe masat përkatëse të gjobës. Ankimi bëhet sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Në kreun 12, në një nen të veçantë 47, është integruar një parim sipas së cilit ndotësi paguan dëmshpërmbimin financiar. Ky parashikim nuk është në rregulloren që përafrohet por është në harmoni me të dhe individët ose operatorët që me veprime ose me mosveprime, krahas dënimeve apo përgjegjësisë penale, paguajnë dëmshpërmbimin financiar për dëmin e shkaktuar.

Kreu 13, ka dispozitat kalimtare dhe të fundit.

Aktet nënligjore do miratohen në periudhën nga hyrja në fuqi deri në shtrirjen e efekteve të ligjit kohështrirje në të cilën operatorët dhe autoritetet kompetente do përgatiten për zbatimin e ligjit. Përcaktohet se aktet nënligjore do miratohen brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, çka garanton shtrirjen e efekteve njëkohësisht si të ligjit dhe të akteve nënligjore. Neni 51 përcakton ndryshime në disa ligje, konkretisht, në Ligjin Nr.10465/2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë”.

Hyrja në fuqi është parashikuar 15 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare ndërsa shtrirja e efekteve do filloj nga data 1 shkurt 2026.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij projektakti janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe autoritetet kompetente.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk mbart efekte financiare shitesë për buxhetin e shtetit.